

Kodi i Etikës së Furnitorëve të Microsoft

Microsoft aspiron të jetë më shumë sesa një kompani e mirë, ajo aspiron të jetë një kompani e shkëlqyer. Drejt këtij qëllimi, ne jemi të përkushtuar në misionin tonë për të ndihmuar njerëzit dhe bizneset në mbarë botën që të kuptojnë nivelet më të larta të produktivitetit dhe suksesit. Arritja e misionit tonë nuk është thjesht ndërtimi i teknologjisë inovative. Por është gjithashtu edhe kush jemi ne si kompani dhe si individë, si e menaxhojmë ne biznesin tonë nga brenda dhe se si punojmë me klientët, partnerët, qeveritë, komunitetet dhe furnitorët.

Përmes Standardeve të Etikës së Biznesit (<http://aka.ms/microsoftethics>), Microsoft ka përcaktuar standardet e kompanisë që përfshijnë praktikën etike të biznesit dhe pajtueshmërinë rregullatore. Këto standarde aplikohen për të gjithë punonjësit, drejtorët dhe zyrtarët e Microsoft. Në mënyrë të ngjashme, Microsoft pret që furnitorët e tij të përqafojnë këtë përkushtim ndaj integritetit duke qenë në pajtim me Kodin e Sjelljes së Furnitorëve të Microsoft dhe duke i trajnuar punonjësit sipas tij.

PAJTUESHMËRIA ME KODIN E ETIKËS SË FURNITORIT

Furnitorët dhe punonjësit, agjentët dhe nënkontraktorët e tyre (në mënyrë kolektive të referuar si "Furnitorët") duhet të zbatojnë këtë Kod Etike të Furnitorit **gjatë kryerjes së biznesit me ose për llogari të Microsoft**. Furnitorët duhet të njoftojnë menjëherë kontaktin e tyre të Microsoft (ose një anëtar të menaxhimit të Microsoft) kur zhvillohet ndonjë situatë që bën që Furnitori të veprojë në shkelje të këtij Kodi Etike. Ndërsa prej Furnitorëve të Microsoft pritet që të monitorojnë dhe të demonstrojnë pajtueshmërinë e tyre me këtë Kod Etike, Microsoft mund të auditojë Furnitorët ose të inspektojë ambientet e Furnitorëve për të konfirmuar pajtueshmërinë e tyre. Microsoft mund të kërkojë heqjen e menjëhershme të çdo përfaqësuesi apo personeli të Furnitorit që sillen në një mënyrë që është e paligjshme apo e papajtueshme me këtë Kod Etike ose ndonjë politikë të Microsoft. Pajtueshmëria me këtë Kod Etike dhe pjesëmarrja në trajnimet mbi këtë Kod Etike, siç mund të ofrohen nga Microsoft, janë të detyrueshme përveç detyrimeve të tjera në ndonjë marrëveshje që Furnitori mund të ketë me Microsoft.

PRAKTIKAT E PAJTUESHMËRISË LIGJORE DHE RREGULLATORE

Të gjithë Furnitorët e Microsoft duhet ta zhvillojnë biznesin e tyre në përputhje të plotë me ligjet dhe rregulloret në fuqi ndërsa bëjnë biznes me dhe/ose për llogari të Microsoft dhe duhet, pa kufizime:

- **Tregtia:** Të jenë në pajtim me të gjitha kontrollet tregtare, si edhe me të gjitha ligjet dhe rregulloret për eksportin, riekportin dhe importin.
- **Antitrusti:** Të zhvillojnë biznesin në pajtueshmëri të plotë me ligjet antitrust dhe të konkurrencës së ndershme që drejtojnë juridiksionet në të cilat kryejnë biznes.
- **Bojkotet:** Të mos marrin pjesë në bojkote ndërkombëtare që nuk janë sanksionuar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara (SHBA) ose ligjet në fuqi.
- **Antikorrupsioni:** Të mos marrin pjesë në rryshfete apo haraçe të çdo lloji, qoftë në marrëdhëniet me zyrtarët publikë apo individët në sektorin privat. Microsoft është i përkushtuar për zbatimin e standardeve të etikës të përcaktuara në Ligjin e SHBA-së për Praktikën e Huaja Korruptive ("FCPA") dhe ligjet antikorrupsion dhe kundër pastrimit të parave të vendeve në të cilat vepron Microsoft. Furnitorët duhet të jenë në pajtim me të gjitha ligjet antikorrupsion dhe kundër pastrimit të parave, duke përfshirë FCPA, si edhe ligjet që drejtojnë lobimet, dhuratat dhe pagesat për zyrtarët publikë, ligjet e kontributeve në fushat politike, si edhe rregulloret e tjera të ngjashme. Furnitorët nuk duhet, në

mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, t'i ofrojnë apo t'i paguajnë diçka me vlerë (duke përfshirë udhëtime, dhurata, shpenzime pritjeje dhe donacione bamirëse) asnjë zyrtari apo punonjësi të ndonjë qeverie, agjencie qeveritare, partie politike, organizate ndërkombëtare publike apo kandidati për post politik (i) për të influencuar në mënyrë të papërshtatshme ndonjë veprim apo vendim të zyrtarit, punonjësit apo kandidatit për qëllimin e promovimit të interesave të biznesit të Microsoft në ndonjë aspekt, ose (ii) për të promovuar ndryshe në mënyrë të papërshtatshme interesat e biznesit të Microsoft në ndonjë aspekt. Si përfaqësues të Microsoft, Furnitorët duhet të jenë në pajtim në të gjitha aspektet me Politikën Antikorrupsion të Microsoft për Përfaqësuesit në <http://aka.ms/microsoftethics/representatives>.

- **Aksesueshmëria:** Krijimi i produkteve dhe shërbimeve që janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara është një parim kyç i kulturës së Microsoft, për të përmbushur jo vetëm detyrimet tona ligjore por edhe misionin e fuqizimit të çdo personi në planet për të bërë më shumë. Furnitorët e Microsoft duhet:
 - Të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për aksesueshmëri në rrjet, Udhëzimet e Aksesueshmërisë së Përmbajtjes së Rrjetit (WCAG) 2.0, Niveli AA gjatë krijimit të një uebsajti të gatshëm për t'u dorëzuar.
 - Të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat dhe standardet e Microsoft për krijimin e produkteve të aksesueshme.

PRAKTIKAT DHE ETIKA E BIZNESIT

Furnitorët e Microsoft duhet të zhvillojnë marrëdhëniet dhe aktivitetet e biznesit të tyre me integritet dhe duhet, pa kufizime:

- **Regjistrat e biznesit:** Të regjistrojnë dhe raportojnë me ndershmeri dhe saktësi të gjithë informacionin e biznesit dhe të jenë në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e tyre. Të krijojnë, mbajnë dhe eliminojnë regjistrat e biznesit në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat në fuqi ligjore dhe rregullatore. Të jenë të ndershëm, të drejtpërdrejtë dhe të vërtetë në diskutimet me përfaqësuesit e agjencive rregullatore dhe zyrtarët qeveritarë.
- **Shtypi:** Të flasin me shtypin për llogari të Microsoft vetëm nëse Furnitori ka marrë nga Microsoft autorizimin e shprehur me shkrim për ta bërë këtë.
- **Dhuratat:** Të shmangin dhuratat për punonjësit e Microsoft sepse edhe një dhuratë me qëllime të mira mund të përbëjë rryshfet në rrethana të caktuara ose mund të krijojë konflikte interesi. Të mos ofrojnë asgjë me vlerë për të arritur ose ruajtur një përfitim apo avantazh për dhuruesin dhe të mos ofrojnë asgjë që mund të duket se influencon, komprometon gjykimin apo detyron një punonjës të Microsoft. Nëse ofrohet një dhuratë, ushqim apo argëtim për punonjësit e Microsoft, përdorni gjithmonë gjykimin e mirë, arsyen dhe maturinë. Çdo dhuratë nga një Furnitor duhet të jetë e lejuar sipas politikës së njësishme të biznesit të punëdhënësit të Microsoft dhe vendit, sepse biznesi i Microsoft dhe politikat rajonale mund të ndalojnë dhuratat krejtësisht ose mund të caktojnë limite maksimale për vlerën e dhuratave në shumën e ndryshme. Çdo dhuratë, ushqim apo argëtim duhet të jetë në përputhje me ligjet në fuqi, nuk duhet të shkelë politikat e dhuruesit dhe/ose marrësit për këtë çështje, dhe duhet të jenë në përputhje me zakonet dhe praktikat vendase. Furnitorët nuk lejohet t'u japin dhurata të çfarëdo vlere anëtarëve të Grupit Global të Prokurimeve (GPG) ose përfaqësuesve të tij.
- **Konfliktet e interesit:** Të shmangin parregullsitë ose konfliktet e interesit në dukje, ashtu edhe ato reale. Furnitorët nuk duhet të punojnë direkt me ndonjë punonjës të Microsoft të cilit bashkëshorti/bashkëshortja, partneri/ja shtëpiak(e) ose anëtarët e tjerë të familjes apo të afërm mban interes të konsiderueshëm financiar te Furnitori. Gjatë periudhës së negociimit të marrëveshjes së

Furnitorit ose gjatë zbatimit të detyrimeve të tij, ndalohen gjithashtu marrëdhëniet e drejtpërdrejta me bashkëshorten/bashkëshortin, partnerin ose me anëtarë të tjerë të familjes apo të afërm të punësuar nga Microsoft.

- **Tregtimi me informacione të brendshme:** Të shmangin tregtimin me informacione të brendshme duke mos blerë apo shitur aksione të Microsoft apo ndonjë kompanie tjetër kur zotërojnë informacion rreth Microsoft apo një kompani tjetër që nuk është i disponueshëm për publikun investues dhe që mund të ndikojë vendimin e një investitori për të blerë ose shitur aksionin.

PRAKTIKAT E PUNËS DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Microsoft pret prej Furnitorëve të tij që të ndajnë përkushtimin e tij ndaj të drejtave të njeriut dhe mundësive të barabarta në vendin e punës. Të gjithë Furnitorët e Microsoft duhet t'i zhvillojnë praktikatat e punësimit në përputhje të plotë me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi dhe duhet, pa kufizime:

- Të bashkëpunojnë me përkushtimin e Microsoft për një forcë punonjëse dhe vend pune pa ngacmime dhe diskriminime të paligjshme. Ndërsa ne pranojmë dhe respektojmë ndryshimet kulturore, ne kërkojmë që Furnitori të mos përfshihet në diskriminime në punësimin, kompensimin, aksesin në trajnim, promovimin, pushimin nga puna dhe/ose pensionimin bazuar në racën, ngjyrën, gjininë, origjinën kombëtare, besimin fetar, moshën, aftësinë e kufizuar, identitetin ose shprehjen gjinore, gjendjen civile, shtatzëninë, orientimin seksual, përkatësinë politike, anëtarësinë në sindikata apo statusin e veteranit.
- Të përdorin vetëm punën e vullnetshme. Është i ndaluar përdorimi i punës së detyruar qoftë në formën e punës së papaguar, punës nën detyrim apo punës së të burgosurve nga Furnitorët e Microsoft. Gjithashtu është e ndaluar mbështetja e çdo forme të trafikut të qenieve njerëzore e punës së pavullnetshme përmes kërcënimit, detyrimit, pretendimeve mashtruese apo detyrimit të formave të tjera.
- T'i sigurojnë punëtorit akses në dokumentet e punës. Furnitorëve u ndalohet që t'u kërkojnë punëtorëve të vendosin "depozita", të mbajnë dokumentet e identitetit apo të emigracionit të punëtorëve (duke përfshirë pa u kufizuar me pasaporta ose lejet e punës) ose të shkatërrojnë, fshehin, konfiskojnë apo të refuzojnë ndryshe aksesin e punëtorëve në këto dokumente. Punëtorët duhet të jenë të lirë të japin dorëheqjen nga punësimi i tyre në përputhje me ligjet ose rregulloret vendase dhe kombëtare pa pësuar dënime të paligjshme. Furnitorët që punësojnë punëtorë për prodhim dhe punë për paketimin e produkteve të Microsoft që nuk janë shtetas të vendit në të cilin zhvillohet puna dhe që janë sjellë në atë vend me qëllim që të punojnë për furnitorin, duhet t'i sigurojnë transportin e kthimit në vendin e tij/saj të origjinës, ose t'i rimbursojnë punëtorit koston e këtij udhëtimi në përfundim të punësimit.
- Të jenë në përputhje me të gjitha ligjet ose rregulloret vendore dhe kombëtare të moshës minimale të punës dhe të mos përdorin punën e fëmijëve. Furnitorët nuk mund të punësojnë persona nën 15 vjeç, nën moshën për përfundimin e arsimit të detyruar, apo nën moshën ligjore minimale të punësimit, cilado prej tyre është më e lartë. Microsoft mbështet vetëm zhvillimin e programeve legjitime të praktikës në vendin e punës për përfitime arsimore të të rinjve dhe nuk bën biznes me ata që abuzojnë me këto sisteme. Punëtorët nën moshën 18 vjeçare nuk mund të kryejnë punë të rrezikshme dhe mund të kufizohen nga puna gjatë natës, duke u dhënë përparësi nevojave arsimore.
- Të mos përfshihen në disiplinë apo abuzim fizik. Janë të ndaluara abuzimi apo disiplina fizike, kërcënimi me abuzim fizik, seksual apo ngacmime të tjera dhe abuzimi verbal apo format e tjera të frikësimit.
- Të paguajnë pagat ligjore në fuqi me kushte njerëzore. Të gjithë punëtorëve duhet t'u jepet informacion i qartë dhe i kuptueshëm rreth kushteve të punësimit në një gjuhë që punëtori e kupton në lidhje me

pagat, përfitimet, vendin e punës, kushtet e jetesës, kostot e strehimit dhe të tjera shoqëruese, duke përfshirë kostot që i ngarkohen punonjësit dhe, nëse zbatohet, natyrën e rrezikshme të çdo pune përpara se të hyjnë në marrëdhënie pune dhe sipas nevojës gjatë kohëzgjatjes së punësimit. Nuk do të lejohen zbritjet nga rrogat si masë disiplinore dhe as nuk do të lejohen zbritjet nga rrogat për të cilat nuk shprehet ligji kombëtar ose ligji vendor pa lejen e shprehur me shkrim të punëtorit në fjalë. Çdo masë disiplinore duhet të regjistrohet. Rrogat dhe përfitimet që paguhën për një javë standarde pune duhet të jenë në përputhje me standardet ligjore vendore dhe kombëtare.

- Nëse punësohen punëtorë për prodhim dhe punë për paketimin e produkteve të Microsoft, sigurohuni që agjencitë e punësimit palë të treta, nëse përdoren, të jenë në përputhje me dispozitat e këtij Kodi Etike të Furnitorëve dhe kërkesat ligjore; si dhe të jenë përgjegjës për pagesën e të gjitha tarifave dhe shpenzimeve që lidhen me rekrutimin. Nëse këto tarifa konstatohet se janë paguar nga punëtorët, këto tarifa do t'u ripaguhën punëtorëve.
- Të ofrojnë përfitime për punonjësit në nivelet e pritshme në industri dhe në përputhje me kërkesat e Microsoft.
- Të mos u kërkojnë punëtorëve të punojnë më shumë se maksimumi i orëve të punës në ditë të përcaktuar nga ligjet ose rregulloret vendore dhe kombëtare. Furnitorët duhet të sigurohen që koha shtesë është e vullnetshme dhe e paguar në përputhje me ligjet ose rregulloret vendore ose kombëtare. Një javë pune nuk duhet të jetë më shumë se 60 orë në javë, duke përfshirë kohën shtesë, përveç rasteve të urgjencës ose situatave të pazakonta. Punëtorët duhet të lejohen të paktën një ditë pushim për çdo javë shtatëditore.
- Mbani regjistra për punonjësit në përputhje me ligjet ose rregulloret vendore ose dhe jepni në kohë, përmes fletëpagesës ose dokumenteve të ngjashme, bazën sipas të cilës paguhën punonjësit.
- Respektoni të drejtat e punëtorëve për liri shoqërimi dhe marrëveshje kolektive në përputhje me kërkesat ligjore. Siç përmendet më lart, kërkojmë që Furnitorët të mos përfshihen në diskriminim në punësim, kompensim, akses në trajnim, promovim, pushim nga puna dhe/ose pensionim bazuar në anëtarësimin në sindikata.

SHËNDETI DHE SIGURIA

Furnitorët e Microsoft pritet që të integrojnë praktika të mira të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në të gjitha aspektet e punës dhe duhet, pa kufizime:

- Të sigurojnë një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm pune dhe të jenë plotësisht në pajtim me të gjitha ligjet, rregulloret dhe praktikën e ligjeve të sigurisë dhe shëndetësore, duke përfshirë ato që aplikohen në fusha të sigurisë në punë, përgatitjes për urgjenca, lëndimet dhe sëmundjet gjatë punës, higjienën personale, punën kërkuese fizike, ruajtjen nga makineritë, dezinfektimin, ushqimin dhe strehimin. Duhet të merren hapa të përshtatshëm për të minimizuar shkaqet e rreziqeve që lidhen me mjedisin e punës.
- Të ndalojnë përdorimin, zotërimin, shpërndarjen ose shitjen e drogave të paligjshme gjatë kohës që ndodhen në prona të zotëruara ose të marra me qira nga Microsoft.

RREGULLORET DHE MBROJTJA MJEDISORE

Microsoft pranon përgjegjësinë e tij sociale për të mbrojtur mjedisin dhe pret që Furnitorët të ndajnë përkushtimin e tij duke iu përgjigjur sfidave që paraqesin ndryshimet klimatike dhe të punojnë drejt mbrojtjes së mjedisit. Si pjesë e këtij përkushtimi, të gjithë Furnitorët e Microsoft duhet, pa kufizime:

- Të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret mjedisore në fuqi rreth lëndëve të rrezikshme, emetimeve në ajër, shkarkimeve të mbetjeve dhe ujërave të zeza, duke përfshirë prodhimin, transportimin, ruajtjen, eliminimin dhe lëshimin në mjedis të këtyre lëndëve.
- Të përpiqen të reduktojnë ose eliminojnë mbetjet e të gjitha llojeve, duke përfshirë ujin dhe energjinë, duke zbatuar masat e duhura të ruajtjes në mjediset e tyre, përmes proceseve të tyre të mirëmbajtjes së tyre dhe prodhimit, si dhe përmes riciklimit, ripërdorimit ose zëvendësimit të materialeve.
- Të marrin, ruajnë dhe mbajnë aktuale të gjitha lejet dhe regjistrimet e kërkuara mjedisore dhe të ndjekin kërkesat operacionale dhe raportuese të këtyre lejeve.
- Nëse zbatohet, të identifikojnë lëndët kimike ose lëndët e tjera që lëshohen të cilat përbëjnë kërcënim për mjedisin dhe t'i menaxhojnë ato siç duhet për të siguruar trajtimin e tyre të sigurt, lëvizjen, ruajtjen, përdorimin, riciklimin ose ripërdorimin dhe eliminimin.
- Të zbatojnë të gjitha ligjet, rregulloret dhe kërkesat e konsumatorëve në fuqi në lidhje me ndalimin ose kufizimin e substancave specifike, duke përfshirë etiketimin për riciklim dhe eliminim.

MBROJTJA E ASETVE DHE E PRONËS INTELEKTUALE

Mbrojtja e të drejtave të pronës intelektuale është jetësore për çdo kompani. Microsoft varet nga prona intelektuale të tilla si informacioni, proceset dhe teknologjia. Të gjithë Furnitorët e Microsoft duhet, pa kufizime:

- Të respektojnë dhe të mbrojnë të drejtat e pronës intelektuale të të gjitha palëve duke përdorur vetëm teknologjinë e informacionit dhe softuerët që janë blerë dhe licencuar në mënyrë legjitime. Të përdorin softuerë, harduerë dhe përmbajtje vetëm në përputhje me licencat e tyre shoqëruese ose kushtet e përdorimit.
- Të mbrojnë dhe të përdorin me përgjegjshmëri asetet fizike dhe intelektuale të Microsoft, duke përfshirë pronën intelektuale, pronën e trupëzuar, furnizimet, materialet e konsumit dhe pajisjet, kur autorizohen nga Microsoft për t'i përdorur këto aset.
- Të përdorin teknologjinë e informacionit dhe sistemet e siguruar nga Microsoft (duke përfshirë emailin) vetëm për qëllime pune të autorizuara nga Microsoft. Microsoft i ndalon rreptësisht Furnitorët që të përdorin teknologjinë dhe sistemet e siguruar nga Microsoft (i) për të krijuar, aksesuar, ruajtur, printuar, kërkuar ose dërguar materiale që janë frikësuese, ngacmuese, kërcënuese, abuzuese, të natyrës seksuale ose ndryshe ofenduese ose të papërshtatshme, ose (ii) për të dërguar komunikime të rreme, fyese ose keqdashëse.
- Të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat dhe procedurat e Microsoft për ruajtjen e fjalëkalimeve, konfidencialitetit, sigurisë dhe privatësisë si kusht për t'i siguruar Microsoft mallra dhe shërbime ose për të marrë akses nga Microsoft në rrjetet e brendshme, sistemet dhe ndërtesat korporative të Microsoft. Të gjitha të dhënat e ruajtura ose të transmetuara në pajisjet e zotëruara ose të marra me qira nga Microsoft duhet të konsiderohen private dhe janë pronë e Microsoft. Microsoft mund të monitorojë të gjithë përdorimin e rrjetit korporativ dhe të gjitha sistemet (duke përfshirë emailin) dhe mund të aksesojë të gjitha të dhënat e ruajtura ose të transmetuara duke përdorur rrjetin e Microsoft.
- Të jenë në përputhje me të drejtat e pronësisë intelektuale të Microsoft dhe të tjerëve duke përfshirë, pa u kufizuar me, të drejtat e autorit, patentat, markat tregtare dhe sekretet tregtare; dhe të menaxhojnë transferimin e teknologjisë dhe të ekspertizës në mënyrë të tillë që mbron të drejtat e pronës intelektuale.

RAPORTIMI I SJELLJEVE TË DYSHIMTA

Nëse dëshironi të raportoni sjellje të dyshimta apo shkelje të mundshme të Kodit të Etikës të Furnitorëve, ju inkurajojmë të bashkëpunoni me kontaktin kryesor të Microsoft për të zgjidhur shqetësimin tuaj. Nëse kjo nuk është e mundur ose e përshtatshme, ju lutemi kontaktoni me Microsoft përmes njëres prej mënyrave të mëposhtme:

- **Telefoni:** Linja e Kodit të Etikës në Biznes e Microsoft në numrin 1-877-320-MSFT (6738). Nëse telefononi nga jashtë Shteteve të Bashkuara, mund të kryeni një telefonatë me pagesë nga pritësi te Linja e Etikës në Biznes duke u lidhur me një operator ndërkombëtar dhe duke kërkuar që të kryeni një telefonatë me pagesë nga pritësi në numrin +1-470-219-7078.
- **Emaili:** Nëse jeni Furnitor me akses në intranetin e Microsoft, mund t'i dërgoni një email Drejtorit të Përputhshmërisë në adresën përkatëse të Etikës në Biznes dhe Përputhshmërisë në buscond@microsoft.com.
- **Email:** Dërgojini një letër Drejtorit të Përputhshmërisë në adresën Microsoft Corporation, Legal and Corporate Affairs, One Microsoft Way, Redmond, WA 98052.
- **Faks:** Dërgojini një faks Drejtorit të Përputhshmërisë në numrin 1-425-708-7177.

Microsoft do të ruajë konfidencialitetin deri në shkallën më të lartë të mundshme dhe nuk do të tolerojë asnjë shpagim apo hakmarrje që merret kundër individëve të cilët, në mirëbesim, kanë kërkuar këshillë apo kanë raportuar një sjellje të dyshimtë apo shkelje të mundshme të këtij Kodi të Etikës të Furnitorëve.